

VENDIM
Nr.327, datë 29.3.2005

MBI LICENCËN PËR TV VENDOR PRIVAT “SKAMPA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.255, datë 31.8.2004 “Mbi vlefshmërinë e licencës së TV Skampa”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i heqë subjektit fizik, z.Genti Ceka licencën për televizionin vendor TV Skampa.
2. Licenca nr.027/TVL bëhet e pavlefshme.
3. T’i japë subjektit, shoqërisë “TV Skampa” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Elbasanit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
4. Licenca bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj